



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.116/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Afijete Sada - Glllogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Alternativa dega në Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Gjakovë, për shkak të vendosjes së posterëve në hapësira publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 06.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa ZL.Anr.116/2017 e datës 02.10.2017, e parashtruar nga subjekti politik Alternativa dega në Gjakovë, me të cilën pretendon se subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka shkelur Nenin 33 pika b, të LZP-së duke vendosur pllakata dhe poster në shtylla ndriqese dhe mbi rrugë publike.

A r s y e t i m

Me datën. 02.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Alternativa me të cilën pretendon se subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka shkelur Nenin 33 pika b, të LZP-së duke vendosur pllakata dhe poster në shtylla ndriqese dhe mbi rrugë publike.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur pesë fotografi të printuara.

Në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), të datës 03.10.2017, deklaroi se vendosja e materialeve reklamuese në hapësirat e cekura në ankesë është bërë nga kompania e marketingut Selmans Network sh.p.k e cila ka kontratë me AAK - në për blerjen dhe shfrytëzimin e këtyre hapësirave reklamuese.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur kontratën me kompanin në fjalë. Po ashtu kanë bashkëngjitur 5 pesë fotografi ku shihen billboard të subjektit politik Alternativa të vendosur në hapësira reklamuese nga e njëjta kompani.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politik AAK, Paneli i vlerësoi se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 pika b) të LZP-së, për arsye se vendosja e pllakatave dhe posterëve siç shihet nga fotot është bërë në vendet e lejuara për reklamim.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.116/2017 me datën 06.10.2017.

Kryesues i Panelit

Rafet Haxhaj

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118,4 të LZP-së.*